



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 784 Prot.

Shkodër, më 19.02. 2026

V E N D I M

Nr. 68, datë 19.02 2026

"PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026"

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma h; të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026"; VKM nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; të Udhëzimit nr.2, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" (i ndryshuar); Udhëzimit plotësues n.2, datë 14.01.2026 të MF "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; Udhëzimit të Përbashkët nr.20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor"; Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" (i ndryshuar), Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 19.02.2026

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit për vitin 2026 sipas materialit bashkëlidhur.
2. I përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tonin GJURAJ



Mbi realizimin e buxhetit vjetor 2025 dhe planin buxhetor vjetor 2026

Materiali i buxhetit paraqitet pranë jush në mbështetje të: ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, shkresës së MAS (Email) datë 06.01.2026 në të cilin jepen fondet e miratuara për vitin 2026, VBA nr. 13, datë 01.01.2026 “Për detajimin e grantit 2026 (grant i mësimdhënies), Senatit Akademik/ Bordit të Administrimit i paraqitet “Relacion mbi realizimin e buxhetit vjetor 2025 dhe Plan buxheti vjetor 2026”, bazuar në kërkesat e fakulteteve.

1. Tregues të përgjithshëm

Disa tregues strukturorë, ekonomikë e financiarë, me të cilët paraqitet Universiteti, në vitin akademik 2025-2026, mbi të cilin bazohet buxheti i vitit 2026.

Universiteti i ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative nëpërmjet Rektoratit, fakulteteve të ndara në njësitë bazë akademike e kërkimore.

➤ Organizimi i strukturave

A. Rektorati

- ◇ Rektor
- ◇ Zv/Rektor
- ◇ Administrator
- ◇ Drejtori/Njësi
- ◇ Biblioteka

B. Fakultetet

- ◇ Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- ◇ Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- ◇ Fakulteti i Drejtësisë
- ◇ Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- ◇ Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- ◇ Fakulteti Ekonomik

Në strukturën e Universiteti bëjnë pjesë gjithashtu edhe dy Qendra Kërkimore:

Qendra Kërkimore e Albanologjisë

Qendra e Studimit të ujërave në rajonin e Shkodrës.

Të cilat përfshihen respektivisht në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës.



Në vijim dhe zhvillim të objektivave të përcaktuara në projektbuxhetin afatmesëm 2026-2028, Universiteti i Shkodrës thekson ambicjet e tij për:


- Krijimin e një kampusi Universitar
- Marrjen në pronësi të godinës së ish Spitalit psikiatrik ose Sanatoriumit
- Investimin në Inteligjencë Artificiale
- Rritjen e mbështetjes për Kërkimin Shkencor

Duhet te kemi parasysh qe:


Inteligjenca Artificiale përkufizohet si aftësia e sistemeve informatike për të analizuar informacion, për të identifikuar modele dhe për të mbështetur proceset e vendimmarrjes. Në universitet, AI mund të shërbejë si mjet analitik dhe organizativ, jo si zëvendësues i gjykitimit akademik. AI mund të ofrojë analiza mbi performancën e studentëve, të ndihmojë në përgatitjen e materialeve mbështetëse dhe të identifikojë vështirësi të përbashkëta mësimore, duke ruajtur vendimmarrjen akademike ekskluzivisht në dorën e pedagogëve. Në këtë kontekst, shihet i nevojshëm buxhetimi i fondeve për platforma të AI, fillimisht bazike të cilat do të shërbejnë për trajnimin e stafit dhe studentëve në këtë fushë dhe me pas implementimin e tyre në procese të ndryshme akademike.

➤ **Personeli akademik dhe personeli ndihmës**
(Ndihmës akademik me karakter administrativ dhe administrativ)

Në Universitetin e Shkodrës numri i punonjësve në dhjetor 2025 është 319 Punonjës punonjës akademikë, ndihmës akademikë e administrativë. Nga numri i punonjësve efektivë të Universitetit, 63% janë punonjës akademikë e 37% punonjës ndihmës akademikë e administrativë.



Punonjësit akademikë Viti 2025




Numri i punonjësve në UNISHK parashikohet të jetë për vitin 2026, 356 punonjës me kohë të plotë dhe 295 me kohë të pjesshme.

➤ Shtrirja dhe mjediset

UNISHK e ushtron veprimtarinë e tij mësimore në territorin e qytetit të Shkodrës.

Sipërfaqja e mjediseve mesimore



Aktualisht UNISHK ka në administrim 8 godina dhe është në proces regjistrimi i tyre.

A. Realizimi i plan buxhetit të vitit 2025

Për vitin 2025 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **713,598** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit dhe trashëgimi nga viti paraardhës. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2024	Financimi (Granti) viti 2025	Buxheti viti 2025
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	83,784,342	629,814,000	713,598,342
TOTALI		83,784,342	629,814,000	713,598,342

a.1. Të ardhurat e vitit 2025

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2025 përveç akordimeve nga Buxheti i Shtetit janë dhe të ardhurat që sigurohen nga arkëtimet që paguajnë studentët, shërbimet ndaj të tretëve dhe disbursimet nga financimet e huaja.

Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e USH - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën **103,576 mijë lekë**. Nga keto, 4,871,926 leke janë sponsorizime me destinacion të caktuar nga sponsori ndërsa 98,704,293 leke janë që destinacioni i përdorimit është në varesë të Universitetit.

a.2. Shpenzimet e vitit 2025

Plan buxheti (Plan Thesari i fillim vitit dhe shtesa gjatë vitit) ka vlerën 743,122 mijë lekë dhe është realizuar financiarisht në vlerën **632,856 mijë lekë**, ose 85.16%
Tabela Përmbledhëse sipas kategorive të shpenzimeve dhe realizimit financiar si më poshtë:

Realizimi viti 2025 000/lekë										
Ilog	Pershkrimi	Granti			Të ardhura			USH		
		Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%
600	Paga	436,061	435,811	99.9	136,546	135,791	99.45	572,607	571,602	99.82
601	Sigurime	77,884	73,270	94.1	18,116	15,429	85.17	96,000	88,699	92.39
602	Shpenzime operative	131,638	73,792	56.1	29,852	28,186	94.42	161,490	101,978	63.15
606	Bursa Studentëve	97,538	49,983	51.2	-	0		97,538	49,983	51.24
231	Investime	0	0		171,597	18,571.9	10.82	171,597	18,572	10.82
TOTALI		743,122	632,856	85.16	356,111	197,978	55.6	1,099,233	830,834	75.6

Sipas burimeve të financimit

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues-investime nga buxheti,) dhe Grantet për shpenzime korrente e bursat e studentëve në vlerën 85.16%
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparshme) të në vlerën 55.6%.

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për periudhën janar-dhjetor 2025 janë mbuluar me fondet nga Granti për shpenzime korrente dhe të ardhurat e Institucionit. Plan i vjetor i pagave është në vlerën 572,607 mije lekë, ndërsa realizimi në nivelin 571,602 mije lekë ose 99.82%.

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është planifikuar në vlerën 96,000 mije lekë dhe është realizuar 92.39%.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Për vitin 2025 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korrente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar financiarisht për periudhën Janar-Dhjetor 2025 në masën 63.23% e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 56.1 % dhe nga të ardhurat 95.12% e planit vjetor. Shpenzimet operative për vitin 2025, janë realizuar kryesisht për: ruajtjen e godinave, elektricitet, mirëmbajtje, taksa e tarifa të institucionit etj.

➤ **Transferta tek individët bursat e studentëve– Artikulli 606**

Realizimi i këtij zëri është në vlerën 49,983 mije leke nga 97,538 mije leke fond në dispozicion.

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e mëposhtme. Shpenzimet në kodet e llogarive 230 dhe 231 janë realizuar financiarisht në masën 10.82%.

B. Plan buxheti i vitit 2026

Hartimi i buxhetit të vitit 2026 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2026-2028, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij; strukturën organizative, programet e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në vijimësi, numrin e studentëve të padiplomuar, realizimit të planbuxhetit të mëparshëm, fondeve të trashëguara të përdorura nga viti 2025, niveli i financimit nga Buxheti i Shtetit (Granti i mësimdhënies).

MASR me (Email), datë 06.01.2026 ka dërguar “Fondet e miratuara për vitin 2026” në vlerën 615,000.0 mijë lekë, fonde të cilat janë detajuar për përdorim (për shlyerjen e detyrimeve: paga e detyrime tjera të muajit dhjetor 2025) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në Degën e Thesarit Shkodër), sipas VBA nr. 13, datë 07.01.2026 “Për detajimin e grantit 2026 (grant i mësimdhënies)”.

Në zbatim të akteve ligjore e n/ligjore për Buxhetin e Arsimit të Lartë Publik, janë organet drejtuese të tyre që ndajnë këto fonde të ngurtësuara për përdorim, për mësimdhënie e për bursa financiare. Këto grante nuk mund të përdoren për investime.

Udhëzimi i përbashkët i MFE-së dhe MASR-s nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor", përcakton se fondi i grantit të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, i papërdorur gjatë vitit buxhetor, mbartet në vitin buxhetor pasardhës. Sipas rakordimit me Degën e Thesarit Shkodër ky fond i papërdorur në vitin 2025 është në vlerën 88,172 mijë lekë dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tij në vitin 2026.

Fondi i papërdorur nga të ardhurat e çelura për përdorim në vitin 2025 dhe grumbullimi i tyre gjatë këtij viti dhe i trashëguar është në vlerën 272,691 mijë lekë dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tyre në vitin 2026. Gjatë vitit 2026 është parashikuar të grumbullohen të ardhura në vlerën 90,000 mijë lekë.

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit për të cilin funksionon Universiteti, përbën buxhetin e vitit 2026 në vlerën 1,065,863 mijë lekë. Buxheti paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2026				lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2025	Financimi viti 2026	Buxheti viti 2026
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	88,172,325	615,000,000	703,172,325
2	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	272,691,341	90,000,000	362,691,341
TOTALI		360,863,666	705,000,000	1,065,863,666

Ky buxhet përbëhet nga:

- ◊ Fonde të mbartura nga viti 2025 prej 360,863.6 mijë lekë, të disponueshme në Degën e Thesarit të cilat përfshijnë:

- fondin e mbartur të financuar nga Buxheti i Shtetit prej 88,172.3 mijë lekë;
- të ardhurat e trashëguara të institucionit prej 272,691.3 mijë lekë;

Fonde të vitit 2026 prej 705,000 mijë lekë, të cilat përfshijnë

- financimin nga Buxheti i Shtetit i fondeve të miratuara për vitin 2026 prej 615,000 mijë lekë;
- të ardhurat e parashikuara për tu grumbulluar të institucionit prej 90,000 mijë lekë.

1. Hyrjet e fondeve për vitin 2026

Në hyrjet e fondeve për Universitetin bëjnë pjesë:

- ◊ Financimi nga Buxheti i Shtetit: Granti konkurrues, Granti për kërkimin shkencor.
- ◊ Granti për mësimdhënie e transfertat tek individët (fondi i bursave për studentët e Ciklit të parë të studimeve),
- ◊ Disbursimet nga projektet me financim të huaj.
- ◊ Të ardhurat e vetë institucionit.

➤ **Financimi nga Buxheti i Shtetit**

Financimi nga Buxheti i Shtetit, bazuar në aktet për financimin e Arsimit të Lartë përbëhet nga

- ◊ Granti për mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve.
- ◊ Transferrat tek studentët – fondet për bursat financiare.
- ◊ Granti konkurrues – për projektet e investimeve nga Buxheti i Shtetit.
- ◊ Granti i kërkimit shkencor.

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme financimi nga Buxheti i Shtetit është 703,172 mijë lekë

Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026				mije lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2025	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2026	Buxheti viti 2026
1	Granti mësimdhënies	40,617	590,000	630,617
2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	47,555	25,000	72,555
TOTALI		88,172	615,000	703,172

➤ **Të ardhura të institucionit**

Fondet të kushtëzuar - të ardhurat e institucionit arkëtohen në bazë të akteve ligjore mbi të cilat është marrë vendim nga Bordi i Administrimit për tarifat e shkollimit dhe tarifave të tjera që arkëtohen nga studentë e shërbime ndaj të tretëve. Këto të ardhura përdoren për financime të aktivitetit akademik, kërkimor e zhvillimin infrastrukturës së universitetit


Fonde të mbartura, financimi të ardhura për vitin 2026				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2025	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2026	Buxheti viti 2026
1	Të ardhura për shpenzime korente (klasifikimi kontabel 600 - paga)	39,933	90,000	129,933
2	Shpenzime operacionale (602)	73,020		73,020
3	Të ardhura për investime (230-231)	159,739	0	159,739
TOTALI		272,691	90,000	362,691

Të ardhurat e institucionit për vitin 2026 janë 362,691 mijë lekë, nga të cilat, sipas kohës së arkëtimit janë:

- Të ardhurat e grumbulluara e të papërdorura për vitin 2025 në vlerën 272,691 mijë lekë

- Të ardhurat e parashikuara për vitin 2026 në vlerën 90,000 mijë lekë
- Të ardhurat e institucionit për vitin 2026, sipas përdorimit në aktivitetin akademik janë:
- Të ardhura për shpenzime paga prej 129,933 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2025 në vlerën 39,933 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2025 në vlerën 90,000 mijë lekë.
 - Të ardhura për shpenzime operacionale prej 73,020 mijë leke te gjitha te mbartura nga viti 2025.
 - Të ardhura për investime prej 159,739 mijë lekë, te gjitha te mbartura nga viti 2025.

Në planifikimin e grumbullimit të ardhurave janë marrë; të dhënat mbi numrin e studentëve, tarifat e shkollimit, sipas niveleve të studimit për vitin akademik 2025-2026



Pesha e tarifave tek të ardhurat e parashikuara të institucionit si vijon:

- Tarifat e shkollimit 82.3 %,
- Të ardhura tjera 14.8%
- Tarifa regjistrimi 2.7 %
- Tarifa konkurrimi 0.2%

Në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit, që duhet të paguajë studenti, rezulton më e lartë se tarifat e ngarkuara, ndërkohë që tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e lartë se kufiri maksimal i vendosur me VKM-n nr. 288 datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar.

Tarifat e shkollimit aktualisht në fuqi për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" bazuar në vendimin e BA nr 211 dt 15.07.2025 për ciklin e parë dhe për ciklin e dytë, janë:

a) Në Ciklin e parë të studimeve tarifa vjetore e shkollimit është:

- *Për program të parë studimi – Bachelor 20,000 lekë, përveç DIND në Drejtësi, Bachelor në Psikologji, Bachelor në punë sociale, Bachelor Pikturë grafike dhe Pedagogji Muzikore. Tarifa për DIND në Drejtësi, Bachelor në Psikologji dhe Bachelor në punë sociale, – 25,000 Lekë. Tarifa për Bachelor në pikturë grafike dhe Bachelor në Pedagogji Muzikore 27,000 Lekë.*
- *Për program të dytë studimi – Bachelor tarifa është 60,000 lekë përveç DND në Drejtësi që është 25,000 Lekë.*
- *Për vitin akademik 2025-2026 e në vijim, studentët në program të parë studimi – Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore 10,000, 12,500 ose 13,500 lekë në varësi të programit të studimit. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore.*

b) Në Ciklin e dytë të studimeve "Master profesional", tarifa për çdo kredit është:

- *Për program të parë studimi 1,000 lekë/kredit nëse është me 60 pikë kredite për program të parë studimi dhe 1,200 lekë për program të dytë, me përjashtim të masterit profesional në gjuhë gjermane, italiane dhe frenge dhe të masterit profesional në mesuesi histori gjeografi dhe gjuhë letersi.*

c) Në Ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave", tarifa për çdo kredit është:

- *Për program të parë dhe të dytë studimi 833.3 lekë/kredit për Master i Shkencave në FD, në studime regjionale në gjeografi, studime të historisë dhe kultures shqiptare, etnokulture dhe letersi shqipe dhe studime të thelluara në gjuhësi.*
- *Për program parë dhe të dytë studimi 1,000 lekë/kredit.*

2. Shpenzimet për vitin 2026

Buxheti i shpenzimeve i vitit 2026 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet: Financimi nga Buxheti i Shtetit: Granti për mësimdhënie e transfertat tek individët (fondi i bursave për studentët e Ciklit të parë të studimeve), Granti konkurrues, Granti për kërkimin shkencor, disbursimet nga projektet me financim të huaj, të ardhurat e vetë institucionit, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore. Table e mëposhtme tregon që nëse lihen në fuqi supozimi që shpenzimet e pagave dhe sigurimeve do të rriten nga 660.3 milione leke në vitin 2025 në 670 milione leke në vitin 2026 dhe tjera shpenzime në varesi të kërkesave të ardhura atëherë nga të ardhurat do të duhet të perdoren 272,565 mijë leke që është shumë afër me nivelin prej 272,691 mijë leke të të ardhurave të trashëguara.

Tabela ne vijim permban fondet me te cilat fillon viti 2026

Total Fondet në dispozicion për vitin 2026 sipas klasifikimit kontabel 000/Lekë					
Nr	Emërtimi shpenzimit	Artik.	Grant	Të ardhura	Total Buxheti
1	Paga e shperblime	600	476,251	19,933	496,184
-	Pagat	600	476,251	19,933	496,184
2	Sig. Shoqërore	601	76,614	-	76,614
3	Shpenzime operative	602	77,677	62,081	139,758
4	Bursa dhe ndihma te menjehershme	606	72,555	0	72,555
5	Transferta	605	75		75
6	Investime	230/231	0	190,678	190,678
a.	Investime patrupëz.	230	-		
b.	Investime trupëz.	231	-	190,678	
	Totali		703,172	272,691	975,864

Sapo te mbyllet kuadrimi me Degen e Thesarit, do te pergatitet vendimi i rialokimit te destinacionit te te ardhurave te trasheguara sipas nevojave qe parashikojme.


Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2026					000/Lekë
Nr	Emërtimi shpenzimit	Artik.	Grant	Të ardhura	Total Buxheti
1	Paga e shperblime	600	476,251,236	103,748,764	580,000,000
-	Pagat	600	476,251,236	103,748,764	580,000,000
2	Sig. Shoqërore	601	76,614,085	13,385,915	90,000,000
3	Shpenzime operative	602	69,874,163	73,020,000	142,894,163
4	Bursa	606	72,554,985	0	72,554,985
5	Investime	230/231	-	80,310,684	80,310,684
	Totali		695,294,469	270,465,363	965,759,832

➤ Paga e shpërblime – Artikulli 600

Fondi i llogaritur për paga nga granti i ardhur në fillim të vitit 2026, është parashikuar në vlerën 476,000 mijë lekë. Kjo duke marrë në konsideratë që grant të trashëguar kemi në vlerën 251 mijë lekë, gjë që bën që fondi i pageve nga granti të arrijë vlerën totale 476,251 mijë lekë. Ky fond, është në gjendje të mbulojë shpenzimet e pagave për numrin e stafit të parashikuar në vendimmarje dhe këtë vit buxhetohen edhe 103,748 mijë lekë për paga nga të ardhurat për efekt mbulimi te nevojave qe nuk plotesohen nga granti.

➤ Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore nga granti i ardhur në fillim të vitit 2026 është parashikuar në vlerën prej 72,000 mijë lekësh. Kjo duke marrë në konsideratë që grant të ne kete ze kemi ne vleren 4,614 mijë leke gje qe ben qe fondi i sigurimeve nga granti te arrije vleren 76,614 mijë leke. Këtë vit buxhetohen edhe 13,385 mijë lekë për sigurime nga të ardhurat.



Shpenzime operative – Artikulli 602

Këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 142,894 mijë lekë. Ky shpenzim do të përballohet nga:

- Granti për mësimdhënie janë detajuar shpenzime operative në vlerën 69,874 mijë lekë për përballimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta: Ujë, energji, telefon, shërbime ruajtje, mirembajtje e shpenzime të tjera operative.
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën 73,020 mijë lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ngrohje si pasojë e rritjes së cmimit të naftës, materiale zyre si pasje e rritjes së cmimit, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh.: shpenzimet për sinjalin e internetit, shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë, etj. Funksionimi i sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat paraqet nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, si dhe nga kërkesat në rritje për disa lloj shpenzimesh.

Grupi “Shpenzime udhëtimi” përfshin pagesën për: udhëtim e dieta brenda vendit, jashtë vendit dhe ekspedita.

✓ **Kancelari në vlerën 3,000 mijë lekë.**

Blerja e kancelarive është shpenzim i vazhdueshëm, pasi ato janë marteriale konsumi. Ndër kancelaritë janë tonera e cartrige për printera e fotokopje, që kanë çmim të konsiderueshëm për njësi. Për vitin 2026 janë parashikuar 3,000 mijë lekë për kancelari nisur edhe nga fakti që ka patur furnizime me kancelari edhe në fillim të vitit 2026. Blerja e tyre kryhet e përqëndruar për organizimin ekonomik me financë në Rektorat, që ka ky universitet, sipas kërkesave të fakulteteve për kancelari.



Emertimi	Parashikimi 2026		
	Total	Grant	Të ardhura
<<Emertimi i Programit>>			
Materiale zyre dhe te pergjithshme	8,220,000	6,720,000	1,500,000
Kancelari	3,000,000	3,000,000	
Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim	1,200,000	1,200,000	
Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	1,200,000	1,200,000	0
Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	120,000	120,000	0
Materiale per funksionimin e pajise te shtypshkronjes.	1,500,000		1,500,000
Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	1,200,000	1,200,000	
Materiale dhe sherbime speciale	10,040,000	1,700,000	8,340,000
Uniforma sportive veshje dhe pajisje te tjera speciale	500,000	500,000	
Veshje diplomimi	4,500,000		4,500,000
Ilace, reagente dhe proteza mjekesore	1,200,000		1,200,000
Materiale dhe pajisje laboratorike te sherbimit publik	1,200,000		1,200,000
Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	1,200,000	1,200,000	
Produkte te dizenuara (suvenire) per organizime te ndryshme	1,200,000		1,200,000
Te tjera materiale speciale	120,000	0	120,000
Te tjera sherbime speciale	120,000	0	120,000
Sherbime nga te trete	55,244,163	54,614,163	630,000
Elektricitet	9,500,000	9,500,000	
Uje	2,700,000	2,700,000	
Sherbime telefonike	0	0	
Sherbime rrjeti RASH	3,500,000	3,500,000	0
Telefoni Celulare	500,000	500,000	
Internet	600,000	600,000	0
Posta dhe sherbimi korrier	200,000	200,000	
Blerje Gazoll	7,000,000	7,000,000	0
Sherbimet bankare	30,000		30,000
Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	29,974,163	29,974,163	
Sherbime te dezinfektimit, pastrimit dhe gjelberimit	600,000		600,000
Kosto e trajnimit dhe seminareve	640,000	640,000	
Shpenzime transporti	1,150,000	900,000	250,000
Karburant per automjetet	900,000	900,000	
Shpenzimet e siguracimit te mjeteve te transportit	250,000		250,000
Shpenzime udhetimi	8,200,000	500,000	7,700,000
Udhetim i brendshem	5,200,000	500,000	4,700,000
Udhetim jashte shtetit+cepus	1,500,000	0	1,500,000
Bileta transporti ajror nderkombetar	1,500,000		1,500,000
Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	21,140,000	840,000	20,300,000
Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	20,000,000		20,000,000
Mbikqyrje Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	300,000	0	300,000
Shpenzime per mirembajtjen e ashensorit	120,000	120,000	0
Shpenzime per mirembajtjen e pompave	120,000	120,000	0
Shpenzime per mirembajtjen e kaldajave	120,000	120,000	0
Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike (Kontrolli v)	240,000	240,000	0
Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	120,000	120,000	
Shpenzime per sherbime fotografike per faqen web	120,000	120,000	
Shpenzime te tjera operative	38,900,000	4,600,000	34,300,000
Shpenzime per pritje e perclenje	2,000,000	2,000,000	
Shpenzime ceremonia e diplomimit+Panairi i punes dhe karrieres	1,000,000		1,000,000
Shpenzime gjyqesore	1,000,000		1,000,000
Shpenzime per sigurimin e ndertesave dhe te tjera kosto sigurim	600,000	600,000	
Shpenzime per honorare	1,000,000	0	1,000,000
Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca (kerkim shkencor)	8,000,000		8,000,000
Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga Institucioni (tarike akreditimi+takse matrikullimi)	11,000,000	2,000,000	9,000,000
Shpenzime parafinancimi Projekti SPEEDY	13,800,000		13,800,000
Shpenzime software antiplagjature dhe te intelligjences artificiale	500,000		500,000
Totali	142,894,163	69,874,163	73,020,000



Zëri “Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga Institucioni është parashikuar në vlerën 11 milionë lekë për akreditimin e programeve të studimit, kërkesën për hapjen e programeve të reja dhe taksa e tarifa të parashikuara për këtë zë.

➤ **Bursat e studentëve – Artikulli 606**

Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit në vlerën 25,000 mijë lekë dhe diferenca e trashëguar nga viti 2025 në vlerën 38,706.7 mijë lekë gjithsej 63,706 mijë lekë.

Kërkesat e studentëve që përfitojnë bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit me kritere të tjera dhe me rezultate janë përpunuar nga komisioni dhe janë hartuar listat përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Aplikimet e studentëve me kritere të tjera janë dërguar në institucionet të cilët kanë detyrimin ligjor për konfirmim të kritereve për të cilat kanë deklaruar online studentët:

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen nga të ardhurat e Universitetit dhe parashikohen në vlerën 80,310.7 mijë leke. Zerat kryesore janë:

-Rikonstruksion catia e FSHE, pjesa 2 në vlerën 11,999,912 leke.

-Pajisje elektronike në vlerën 25,000,000 leke

-Kaldaja në vlerën 19,695,599 leke



Emertimi i projektit te investimit	Draft Buxheti 2026
	Ardhura
Paisje per inventar ekonomik	3,500,000
Furnizim Vendorsje Kondicionere	3,000,000
Paisje elektronike	25,000,000
Blerje libra	3,500,000
Perde	3,000,000
Tela per piano	260,000
Laboratori I grafikes artet	487,000
Laboratori i muzikes	3,641,490
Roll up	200,000
Baner	100,000
Sherbime te rilevimit topografik kadastrale	1,200,000
Blerje paisje dhe materiale për Palestrën	1,200,000
Projektim catia FSHE	60,432
Catia FSHE	11,999,912
Kolaudim catia FSHE	26,400
Mbikqyrje catia FSHE	177,856
Projektim Kaldaja	185,335
Kolaudim kaldaja	32,557
Mbikqyrje kaldaja	453,704
Ndertim i sistemeve te kaldajave	19,695,999
Furnizim vendorsje kabine elektrike FSHE	1,200,000
Stola per ambjente te jashtme	500,000
Laboratori I fotografise artet	890,000
TOTAL	80,310,684